

BASHKIA DURRES



RAPORTI TEKNIK

- 1. "Rikonstuksion rruga Erzeni i vjeter, Vau i Grave, Katundi Ri
L=821ml"**
- 2. "Rikonstuksion rruga Bega, Gjyzeli, Qendra Shendetesore Katundi i RI
L=786ml"**

1. TË PËRGJITHSHME

1.2 Hyrje

Bashkia Durrës kërkon të realizojë projektin e zbatimit me objekt "Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Katundi i Ri"


1.3 Pozicioni i objektit

Vendodhja e objektit është në Njësinë Administrative Katundi i Ri.

Fig 1



Fig 2



Qëllimi i projektit:

- Paraqitja e një projekti të plotë, cilësor dhe bashkëkohor
- Hartimi i projektit sipas legjislacionit në fuqi
- Ndërtimi i korsive të automjeteve
- Projektuesi duhet të kryejë disa vizita në objekt për të bërë konstatimin e të gjithë problematikave në mënyrë që projekti i zbatimit të jetë i plotë.

1.4 Analiza e detyrës së projektimit

Ne detyrën e projektimit, investitori ka paraqitur shkurtimisht gjendjen ekzsituase të zonës si dhe ka parashtruar kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për hartimin e projektit. Nga analiza e detyrës së projektimit evidentohen këto probleme.

- Disa segmente rrugore janë të pashtuara dhe disa janë të dëmtuara
- Trotuar i dëmtuar

Nga grupi i projektimit u hartua 1 variant zgjidhje për problematikat e sipërpërmenduar.

2. GJENDJA EKZISTUESE

2.1 Gjendja ekzistuese

Gjendja ekzistuese e objektit të kësaj kontrate, rezulton sa vijon:

- "Rikonstuksion rruga Erzeni i vjeter, Vau i Grave, Katundi Ri L=821ml" kërkon riparim të shtresave, pjesët e pashtruara kërkon shtrese me stabilizant dhe pastaj shtresat asfaltike .

- "Rikonstuksion rruga Bega, Gjyzeli, Qendra Shendetesore Katundi i RI L=786ml" kërkon riparim të shtresave, pjesët e pashtruara kërkon shtrese me stabilizant dhe pastaj shtresat asfaltike .

3. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Zgjidhja e projektit bazohet në Detyrën e Projektimit që kemi marre nga Titullari i Autoritetit Kontraktor. Në projektin final të zbatimit janë reflektuar sugjerimet e diskutimet që kemi pasur gjatë kësaj kohe me e projektuesit. Sipas variantit të miratuar, ndërhyrja në rrugë do të jenë si më poshtë:

Gjerësia e rrugëve parashikohen të jenë 3 m

Ndërhyrja ne keto rruge konsistojnë ne:

- Germim e shtreses se dobet te rruges.
- Shtresë stabilizanti 10 cm ku ka nevojë
- Shtresat e binderi 6cm për profilimdhe asfalt 4 cm
- Bankinat anesore me cakull.

4. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI NDËRHYRJET NË RRUGË

Në zgjidhjen e projektit janë patur parasysh:

1. Zgjidhja në anën Planimetrike
2. Zgjidhja në anën Altimetrike
3. Elementet sociale

4.1 Zgjidhja Planimetrike (ndërhyrjet).

Në zgjidhjen planimetrike është patur parasysh krijimi i korsive të automjeteve.

4.2 Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik është pothuajse e sheshte. Është synuar që niveleta e tyre të jetë sa më pranë asaj ideale, por duke respektuar edhe kuotat e hyrjeve të objekteve ekzistuese. Gjithashtu është bërë rakordimi në kuotë me rrugët ekzistuese.

5. PUNIME TOPOGRAFIKE

5.1 Përshkrim i përgjithshëm i punimeve Topografike.

Detyrë kryesore për zhvillimin e kësaj zonë është matjet topografike të zonës dhe paraqitja e gjendjes faktike e zonës. Identifikimi i problematikave të ndryshme që mund të hasen në të ardhmen.

Fotografimi ajror do të realizohet me pajisjet e teknologjisë së fundit dronë .

Procesimi i fotove ajrore

Produkti kryesorë që merret nga ky përpunim është fotografimi i rifreskuar i zonës me të gjithë elementet e terrenit. Për të realizuar këtë merren fotot e bëra nga droni përgjat fluturimit dhe importohen në softëarin përkatës 3Dsurvey i cili bën të mundur realizimin e point cloud-it.

Hapi kryesorë është përcaktimi i sistemit koordinativ i zonës ku zona jonë korespondon në sistemin UTM në zonën 34N.

Hapi i dytë është përputhja e pikave të kontrollit GCP të matura në terren me fotot përkatëse si më poshtë. Pas kësaj i gjithë procesi kryhet në mënyrë automatike nga softëari duke na dhënë dhe raportin përkatës për rezultatet e punës, ku në rastin tonë RMS është 0.025m një rezultat mëse i kënaqshëm për kryerjen e punës tonë.

RAPORTI TEKNIK U PERGATIT NGA GRUPI I INXHINIEREVE

Ing. Hidroteknik Lorenc FACJA

Ing. Ndertim Eni TURKESHI

Ing. Ndertim Jetmir KURTI

Arkitekt. Alba KOKOMANI